



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “G.P.G Company” shpk, me administrator Z. Paqsor Buzi, me numër NIPT-i J64324443V me adresë: Fier Lushnje, Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut. 1

Procedura e prokurimit: Procedure e Hapur

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Rikonstruksion rrjet kanalizimi në Rrugën e Elbasanit”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-22818-05-20-2019

Fondi limit: 195.898.533,6 (njëqindë e nëntëdhjetë e pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre presje gjashtë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 4(katër) muaj duke nisur nga data e dorezimit te sheshit te punimit.

Data e zhvillimit të tenderit është: 21.06.2019 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.21 të dates 27/05/2019

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik ”G.P.G Company” shpk NIPT-it J64324443V

Vlera: **155.107.113** (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e njëqind e shtatë mijë e njëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik ”Alba-Constuksion” shpk NIPT-i J61812013R
Vlera: 159.402.921,54 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dy mijë e nëntëqind e njëzet e një presje pesëdhjetë e kater) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik BOE“AGI KONS” SH.P.K. NIPT-i K21622001M
& “BE-IS”shpk NIPT-i K71412003A
Vlera: 165.677.735 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
4. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik ”Pepa Group” shpk NIPT-i L42215009L
“Junik” shpk NIPT-i J68007522L
Vlera: 178.076.128,5 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e tetë presje pesë) lekë pa TVSH
5. Operatori Ekonomik “4 AM” sh.p.k NIPT-i K92005016L
Vlera: 178.246.334,82 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e dyqind e dyzetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e katër presje tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.
6. BOE “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” SH.P.K. NIPT-i K 91326028 I
& “2T” shpk NIPT-i K01731001M
Vlera: 184.144.177,65 (njëqind e tetëdhjetë e katër milion e njëqind e dyzetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
7. Operatori Ekonomik “Salillari” shpk NIPT-i J62903125G
Vlera: 195.498.498 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik ”Pepa Group” shpk & ”Junik” shpk** , me vlerë të ofertës **178.076.128,5** (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e tetë presje pesë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Se pari:Ne dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” /Kapaciteti Teknik pika 2.3 percaktohet se:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga Kavajes Nr.133, Njesia administrative Nr.6,Kodi Postar 1027,
Tel: 00 355 42240978,info@ukt.al.

e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 97.949.266,8 (nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje tetë) **lekë pa TVSH**, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përlogaritur nga data e hapjes së ofertave.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është me vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, datë e përlogaritur nga data e hapjes së ofertave.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë;
 3. Leje ndërtimi/shfrytëzimi për kryerjen e punimeve
 4. Situacionin përfundimtar;
 5. Akt kolaudimi objekti;
 6. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Pepa Group” shpk për të përmbushur kriterin e mësipërm rezultoi se është ngarkuar në platformën elektronike Kontratë Nënkontraktimi midis shoqërisë Junik shpk dhe shoqërisë Pepa Group shpk (nën cilësinë e nënkontraktorit), kontrata me objekt Ndërtim rrjetit të shpërndarjes së ujit të pishëm dhe restaurimit të depove ekzistuese në Bashkinë Fushë-Arrëz, me vlerë nënkontraktimi 57.358.870 (pesëdhjetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga shqyrtimi i Formularit të Vlerësimit rezultoi se vlera e kontratës së mësipërme të lidhur nëpërmjet AK, Bashkia Fushë-Arrëz dhe shoqërisë Junik shpk është 61.742.594 (gjashtëdhjetë e një milion e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, gjithashtu në formularin

e vlerësimit të ngarkuar në sistemin elektronik të app-së citohet se: sipermarrësi “Junik” shpk 100% të vlerës së kontratës me Investitorin dhe Nënkontraktori “Pepa Group” shpk 100% të vlerës së kontratës me sipërmarrësin

Nga sa më sipër kontrata e Nënkontraktimit midis dy shoqërive Junik shpk dhe Pepa Group është lidhur në kundërshtimin me ligjin nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 61 pika 2 ku citohet se Përqindja e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjestim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së përgjithshme të kontratës, si dhe në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 pika 3 ku citohet se “ Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.

Sqarojmë se vlera e përgjithshme e kontratës ka qenë 61.742.594 (gjashtëdhjetë e një milion e shtatëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH , duke përllogaritur 40% të vlerës së kontratës e cila është vlera maksimale lejuar në rastin e nënkontraktimit rezulton se vlera e nënkontraktimit nuk do të ishte më tepër se 24.697.037,6(njëzetë e katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e shtatë presje gjashtë) lekë pa TVSH , ndërkohë që kontrata e nënkontraktimit e lidhur midis dy shoqërive mban një vlerë që tejkalon shprehur në përqindje , vlerën e parashikuar në bazën ligjore dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij.

KVO , sa më sipër e konsideron kontratën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Pepa Group” shpk si kontratë të ngjashme , të lidhur në kundërshtim me nenet e parashikuara në bazën ligjore.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Se dyti :Ne dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” /Kapaciteti Teknik pika 2.3 percaktohet se:

4.Një punësim mesatar i të paktën 150 (njëqind e pesëdhjetë) personave, për periudhën Prill 2018- Prill 2019 të vërtetuar me;

4.1Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Prill 2018- Prill 2019

4.2 List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Prill 2018- Prill 2019.

- Pepa Group shpk ka marre persiper te relaizoj **46%** te punimeve sipas kontratës së bashkepunimit datë 20.06.2019 Nr.rep 5023, kol 139.

Komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se në plotesimin e kësaj pike operatori ekonomik “Pepa Group” shpk ka paraqitur platformen elektronike te app-se listpagesat si dhe vertetimin mbi numrin e punonjesve per muajt Prill 2018- Prill 2019 nga ku rezulton një numer mesatar punonjesish **prej 66.9 punonjesish.**

Per sa mesiper “Pepa Group” shpk nuk disponon numrin e duhur te punonjesve ne baze te perqindjes se marre persiper. Operatori ekonomik duhet te angazhonte ne kontranten objekt prokurimi nje numer **prej 69 punonjesish.**

Pra sa më sipër Shoqëria “Pepa Group” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....***

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 4, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Së treti:Ne dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta per kualifikim” pika 14 është kërkuar ne shtojcen per makinerite që të paraqiten

15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	4 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	4 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse Asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum	4 cope	Pronësi ose me qera

1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë		
Freze asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 150 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- a)** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c)** Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e)** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f)** Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).
- g)** (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 15.06.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shpesh të shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër; dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë

*vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.
Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.*

Operatori Ekonomik “Pepa Group” shpk, ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtëme:

- 1) Autovinç me targa **AA963 AP** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2.1 Ton **(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**
- 2) Kamionçinë targa **AA016PX** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **2 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**
- 3) Kamionçinë targa **AA125UC** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **2 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**
- 4) Kamion me targa **AA559RP** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **7.3 Ton.**
- 5) Kamion me targa **AA346LE** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5.9 Ton**
- 6) Kamion me targa **AA587MD** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **8.4 Ton**
- 7) Kamion me targa **AA815SK** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **6.9 Ton**
- 8) Kamion me targa **AA310PI** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17 Ton**
- 9) Kamionçinë me targa **AA426CZ** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.6 Ton

KVO konstaton se mjetet me targa AA559RP, AA587MD, AA815SK, jane siguruar me anë të kontratës së qerasë Nr.5029 rep , Në përmbushje të kriterit 14 pika a) të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, çerifikatë e pronësisë,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësite

vendore, për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhenesit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qiramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetet do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm

Ndersa për mjetet:

- 1) Kamion me targa **AA346LE** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5.9 Ton. janë siguruar me anë të kontratës së huasë Nr.5028rep.**
- 2) Kamion me targa **AA426C** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16 Ton. **jane siguruar me anë të kontratës së huasë Nr.5028rep**
- 3) Kamion me targa **AA962D** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17 Ton janë siguruar me anë të kontratës së huasë Nr.5028 rep.**
- 4) Kamion me targa **AA310PI** me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17 Ton. janë siguruar me anë të kontratës së huasë Nr.5025 rep**

Referuar kritereve të vendosura nga Autoriteti kontraktor konstatohet se të gjitha mjetet janë kërkuar **në pronësi ose me qera** dhe në asnjë rast nuk është përcaktuar që mjetet mund të paraqiten **me kontratë huapërdorje.**

Pra sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se operatori ekonomik nuk siguron nëpërmjet kontratës së huapërdorjes disponueshmërinë e mjeteve për gjatë gjithë kohës së realizimit të kontratës. KVO referuar kërkesës të vendosur nga autoriteti kontraktor që mjetet **duhet të jenë në pronësi ose me qera** si dhe referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “kontrata e qerasë” është një veprim juridik ndryshe nga “kontrata e huapërdorjes”, të cilat ligjvënësi i trajton në dispozita të veçanta me specifikat e tyre, marrëdhëniet juridike që rregullojnë dhe pasojat (*të drejtat dhe detyrimet*) për çdo palë pjesëmarrëse dhe nënshkruese të këtyre kontratave.

Kontrata e qirasë është një kontratë me të cilën njëra palë (qiradhenësi) detyrohet ti japë palës tjetër (*qeramarrësit*) një send të caktuar në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar. (*Neni 801 i KC*)

Në Kreun IX, “Kontrata e Huapërdorjes”, Neni 901 citohet sa më poshtë:

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshtim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. **Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.**

Neni 907

Në qoftë se gjatë afatit të caktuar, ose përpara se huamarrësi të ketë pushuar së përdoruri sendin sipas kontratës, huadhënësi ndodhet përpara nevojës së ngutshme dhe të paparashikuar të sendit, ai mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e menjëhershëm të sendit.

Pra referuar dhe në kuptim të dispozitës sipërcituar, operatori ekonomik nuk siguron nëpërmjet kontratës së huapërdorjes disponueshmërinë e mjetit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës pasi në çdo moment sendi mund ti kthehet huadhënësit me kërkesën e këtij të fundit (*si një e drejtë legjitime të cilën e sanksionon Kodi Civil*) edhe gjatë kohës që kontrata mund të jetë në vazhdim.

Pra referuar sa më sipër, duke paraqitur kontrata Huapërdorje për mjetet operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e vendosur nga Autoriteti Kontraktor ku specifikisht kërkohej që mjetet që të **jenë në pronësi ose me qira**, dhënia në huapërdorje është në kundërshtim me rregullat e Kodit Rrugor, ku parashikohet se përdorimi nga të tretët i automjeteve përfshin dhënie me qira të tyre pa drejtues mjeti dhe në asnjë rast nuk pranohet dhënia e automjeteve në huapërdorje gjithashtu vlen të theksohet se operatori ekonomik nuk siguron nëpërmjet kontratës së huapërdorjes disponueshmërinë e mjetit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës pasi në çdo moment sendi mund ti kthehet huadhënësit me kërkesën e këtij të fundit.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për kamionët me targa **AA346LE, AA426C, AA962D, AA310PI** nuk është i saktë dhe nuk plotëson kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor në drejtim të disponueshmërisë së mjeteve.

Operatori Ekonomik “Junik” shpk, ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtëme:

- 1) Kamion targa LE9298A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **14.2 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 12-17 ton)**
- 2) Kamion targa LE9298A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **13.6 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 12-17 ton)**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin

mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion kater kamiona **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 12 ton dhe maximum 17 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur **dy** kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion kater kamionçina **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur tre kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi I Operatoreve Ekonomik “është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik ”Alba-Construksion” shpk, me vlerë të ofertës **159.402.921,54** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dy mijë e nëntëqind e njëzet e një presje pesëdhjete e kater) lekë pa TVSH.

Së pari: *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:*

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. **Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

e. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

f. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

g. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit e paraqitur në sistemin elektronik, KVO verën se operatori ekonomik

” **Alba-Construksion**” shpk nuk ka paraqitur shtojcen 1 (Formulari i Ofertës Ekonomike), te kerkuara ne shtojcen 12 te DT.Për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik lidhur me shtojcat është i paplotë, rrjedhimisht i pavlefshëm.

Në shtojcën 12 të DST përcaktohet se.... Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	4 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	4 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Prerëse Asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 150 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë

- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- g) *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 15.06.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.*
- h) *Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.*

Operatori Ekonomik ” Alba-Constuksion” shpk” ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtëme:

- 1) Kamion targa AA496MN me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **10.7 Ton**
- 2) Kamion targa TR5923S me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **8.8 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
- 3) Kamion targa TR5032S me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë

mjet 16.8 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 12-17 ton)

- 4) Kamion targa TR6681N me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **11 Ton**
- 5) Kamion targa TR8023S me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **19.9 Ton**
- 6) Kamionçinë targa AA169RP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.8 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**
- 7) Kamionçinë targa AA185MP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **0.7 Ton**
- 8) Kamionçinë targa TR7926S me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.16 Ton**
- 9) Kamionçinë targa TR7203J me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **0.8 Ton**
- 10) Kamion targa AA774TG me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **8 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
- 11) Kamion me targa AA573SL

KVO konstaton se mjete me targa AA573SL është siguruar me anë të kontratës së qerasë Nr.1094rep,341 kol Nr date.20.06.2019 .

Në përmbushje të kriterit 14 pika a) të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, çertifikatë e pronësisë,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësite vendore, për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë

është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhenesit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qirramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetet do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm..

12) Autobetoniere me targa AA295DS

KVO konstaton se mjete me targa AA295DS është siguruar me anë të kontratës së qerasë në emër të Dragon shpk date.20.06.2019 .

Në përmbushje të kriterit 14 pika a) të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, çertifikatë e pronësisë,taksë vjetore,foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikatat e lëshuar nga njësite vendore, për transport mallrash është cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Dokumentacioni i paraqitur vërteton vetëm faktin se mjetet janë në pronësi të qiradhenesit, por përdorimi i tyre do të ishte i pamundur nga qirramarrësi si në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetet do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm..

13) Eskavator me goma (me faturë doganore)

a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt*

